



SHTËPIA E NGJYRAVE

Një qendër shumëfunktionale shërbimesh
për fëmijët dhe familjet në Tiranë*



Çfarë është Shtëpia e Ngjyrave?

Shtëpia e Ngjyrave, e themeluar që në vitin 2011 është e vetmja qendër jofitimprurëse, e cila siguron shërbime ditore për fëmijët gjatë ditëve të javës nga ora 8.00 deri në orën 17.00 dhe shërbime emergjente të strehimit dhe mbrojtjes së fëmijëve 24 orë në ditë, gjatë 7 ditëve të javës.

Shtëpia e Ngjyrave funksionon në bazë të fondeve të përbashkëta nga UNICEF dhe Bashkia e Tiranës, për t'iu përgjigjur situatave të shfrytëzimit, abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve. Që prej asaj kohe, UNICEF dhe ARSIS (Organizatë shoqërore e përkrahjes së të rinjve) po punojnë në partneritet të ngushtë për të identifikuar, shpëtuar dhe mbështetur

fëmijët dhe nënat e tyre të mbijetuara nga dhuna. Gjithashtu, UNICEF dhe ARSIS po mbështesin edhe punonjësit social të mbrojtjes së fëmijëve dhe Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve për të dhënë shërbime më të mira dhe cilësore për fëmijët e Shqipërisë.

Qendra drejtohet nga organizata jofitimprurëse ARSIS dhe aktualisht ka 33 punonjës (22 me kohë të plotë dhe 11 me kohë të pjesshme) dhe një vullnetar. Në përbërje të personelit janë: punonjës social/menaxher rasti, psikologë, animatorë social, mësues, një infermiere, një avokat, ndërmjetës kulturor, dy financiarë dhe dy punonjës logjistike.

1. UNICEF operates funds from European Union and its on regular resources



Shërbimet e Emergjencës

Shërbimet e Emergjencës përfshijnë strehim, këshillim, mbështetje psiko-sociale dhe asistencë të përgjithshme deri në 72 orë për fëmijët dhe familjet në situatë rreziku. Shtëpia e Ngjyrave mund të presë deri në 7 fëmijë që kanë nevojë për shërbim emergjent. Qendra është e pajisur me personel dhe mjediset e nevojshme për të bërë vlerësimin e gjendjes shëndetësore të fëmijëve dhe për të dhënë ndihmën e parë mjekësore.

ARSIS zbaton një politikë konfidencialiteti që mbrohet rreptësisht të dhënat personale të përfituesve.



Shërbimet ditore

Shtëpia e Ngjyrave ofron shërbime të larmishme për fëmijë dhe familje, nga e hëna në të premte nga ora 08.00 deri në orën 17.00.

Këto shërbime përfshijnë:

- shërbime të statusit civil (regjistrimi),
- shërbime shëndetësore,
- edukim dhe mbështetje për mësimet e shkollës;
- mbështetje psiko-sociale, këshillim ligjor dhe mbështetje administrative;
- këshillim për punësim

Qendra ka: a) klasa për muzikë dhe art; b) 2 mini-kopshte për mësimet e kopshtarisë; c) një fushë të vogël futbollit, për fëmijët që frekuentojnë shërbimet e qendrës ditore.

Çdo fëmijë që hyn për herë të parë në Shtëpinë e Ngjyrave regjistrohet nga personi në detyrë në zonën e pritjes. Pasi vlerësohen në mënyrë të gjithanshme nevojat e fëmijës/familjes, sugjerohet lista e shërbimeve.

Përvec fëmijëve të vegjël, edhe adoleshentët përfitojnë nga një sërë programesh të posaçme, si psh ai për zhvillimin e aftësive për jetën dhe punën. Ata ndihmohen nga stafi i Qendrës që të plotësojnë plane individuale zhvillimi, marrin praktika pune të shkurtra ose të gjata, hartojnë plane karriere ose plane biznesi fillestar.

Shumica e rasteve ndiqet nga afër nga një menaxher rasti në koordinim me një ekip profesionistësh.



Si përfshihet komuniteti?

Një ekip prej 5 ndërmjetësish, të punësuar nga ARSIS, punojnë direkt me njerëzit në komunitetet e synuara, mbledhin opinionet dhe i informojnë ato rreth mundësive që i siguron Shtëpia e Ngjyrave dhe skuadra e ARSIS.



Rezultatet

Përfituesit kryesorë janë komunitetet rome dhe egjiptiane në Tiranë, në 14 zona periferike të kryeqytetit. Gjithsej, 200 familje mbështeten me një paketë të plotë shërbimesh në vit.

Gjithashtu, afro 50 fëmijë, 10 adoleshentë dhe 5 nëna përfitojnë çdo ditë nga lehtësirat dhe programet e Shtëpisë së Ngjyrave



Parimet udhëheqëse të punës së ARSIS-it

- Të kuptojë fëmijët në kontekstin lokal në të cilin jetojnë
- Të punojë me fëmijët në frymën e bashkëpunimit dhe partneritetit bazuar në besimin dhe respektin e ndërsjellë
- Të punojë me fëmijët në mënyra që nxisin aftësitë e tyre dhe zhvillojnë potencialin e tyre
- Të trajtojnë fëmijët me respekt dhe t'i njohë ata si individë me të drejta të plota
- T'i shohë me pozitivitet fëmijët dhe t'i vlerësojë ata si individë me nevoja dhe të drejta të veçanta
- Të vlerësojë mendimin e fëmijëve dhe t'i trajtojë ato me seriozitet.



Policia
Bashkiake

SHTËPIA E NGJYRAVE
THE HOUSE OF COLORS

Universiteti
Europian

Gjimnazi
"Besnik Sykja"

Adresa: Rr Sali Butka, Tiranë
(mbrapa Policisë Bashkiake)





This project is funded by EU



**Me mbështetjen e Komisionit Europian, UNICEF në partneritet me ARSIS sigurojnë strehim emergjent, këshillim psikologjik, mbështetje ligjore dhe shërbime për r kohë n e lirë për fëmijët dhe gratë, mbijetues të abuzimit dhe dhunës. Të gjitha shërbimet janë pa pagesë dhe konfidencialiteti i përfituesve respektohet rreptësisht.*